



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Pesëdhjetë e një (51) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare në shumë të përgjithshme 5,950.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0029543/21
Podujevë, 01 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354/21 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0020426/21, dt. 03.03.2021, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 47 (katër dhjetë e shtatë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e mjedrës.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin “*Furnizim i fermerëve me fidane të Mjadrave*”, përkatësisht deri në vlerën prej 0.70 € për një fidan mjedër, por jo më shumë se 1,120.00 € si vlerë maksimale e mbështetjes për një fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: “*Furnizim i Fermerëve me Fidane të Mjadrave*”, sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/04-0029743/21
Podujevë, 01 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 9 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, të, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË OJQ-ve

Neni 1

Themelohet Komisioni i ankesave në kuadër të Administratës komunale për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve në procesin e financimit publik, në këtë përbërje:

1.Hamide Aliu Selmani, kryesuese, zyrtare për pylltari - Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

2.Ardita Zeka, anëtare, zyrtare për arkiv - Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

3.Naxhije Hasani, anëtare, zyrtare për invalid të luftës dhe familjeve të dëshmorëve – Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z.Avni Maloku, zyrtar për çështje pedagogjike – Drejtorja e Arsimit, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Komisioni ka mandat dy vjeçar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorive përkatëse

Arkivit

Nr. 02-020/04-0029450/21

Podujevë, 01 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 g) dhe 58 b), të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 16, 19 parag.1.7 dhe nenin 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018,

Sipas shkresës/kërkesës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.prot.02-77/3 datë 08.02.2021, dhe shkresës elektronike të datës 04 mars 2021 të Komisionit ndërministror për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit si pasojë e vërshimeve të ndodhura në muajin janar 2021, si dhe sipas Raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, merr këtë,

VENDIM

Neni 1

Lejohet ndarja ndarja e mjeteve buxhetore në shumë 27,700.00€ personave / familjeve të cilat kanë pësuar dëme në ekonominë familjare brenda objekteve të banimit si pasojë e reshjeve dhe vërshimeve të ndodhura gjatë muajit janar 2021, sipas raporteve të vlerësuara nga Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Shuma e mjeteve prej 27,700.00€ është ndarë dhe alokuar Komunës së Podujevës në Kodin buxhetor 18165, kategoria e subvencioneve, nga Ministria e Pushtetit Lokal në rekomandim të Ministrisë së Financave me qëllim që mjetet e ndara t'iu shpërndahen personave / familjeve të dëmtuar/a sipas raporteve të vlerësuara nga Komisioni përkatës komunal.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me të, obligohen Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 4

Pjesë përbërës e këtij vendimi janë raportet vlerësuese të Komisionit së bashku me dokumentacionin dhe shkresat përkatëse të lëndës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot.02-400/03-0030680/21
Podujevë,
06 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Vendimit nr.01/05, datë 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, nxjerr këtë:

URDHËRESË

I

Urdhërohen Drejtorët e Drejtorive, që përveç obligimeve tjera që rrjedhin nga Vendimi nr.01/05 të datës 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, të fillojnë me marrjen e masave të menjëhershme të organizimit të punës në Drejtoritë përkatëse sipas pikave 6 dhe 7 të Vendimit në fjalë, ku shprehimisht thuhet;

- Në institucionet publike dhe private obligohen që të paraqitet në punë vetëm stafi i cili kryen shërbime esenciale. Përgjegjësit e institucioneve publike dhe private obligohen të definojnë stafin esencial për nevojat e institucionit në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
- Punëdhënësit publik apo privat udhëzohen të krijojnë kushtet për kryerjen e detyrave të punës nga shtëpia për punëtorët e tjerë që nuk janë staf esencial për nevojat e punëdhënësit. Obligohet punëdhënësi që në bashkëpunim me punëtorët të definojnë pozitat e punës që mund të kryhen nga shtëpia.

II

Reduktimi i stafit të bëhet në tërësi në Administratën e Komunës së Podujevës, me përjashtim të stafit në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si masë për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19.

III

Zyrtarët komunal që lirohen sipas kësaj Urdhërese obligohen që në raste të domosdoshme, varësisht situatës së krijuar të paraqiten në vendin e punës, sipas kërkesave të drejtorëve të Drejtorive përkatëse.

IV

Zbatimin / implementimin e kësaj Urdhërese e bëjnë Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Zyra e personelit të cilët obligohen të mbajnë evidencën e stafit të liruar dhe atyre që vijojnë në punë si dhe të organizojnë punën gjatë kohës sa kjo Urdhëresë është në fuqi.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe e njëjta vlen varësisht situatës nga pandemia covid-19 dhe akteve të nivelit qendror.

Nr. 02-016/01-0030904/21
Podujevë, 06 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenet 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep :

A U T O R I Z I M

I

Autorizohet znj.Luljeta Osmani, *zyrtare për shërbime sociale 2*, në Qendrën për Punë Sociale (QPS)-Podujevë, të kryej punët dhe detyrat si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të QPS-së.

II

Autorizimi vlen deri në një akt tjetër administrativ.

III

E përmendura sipas këtij autorizimi përfiton pagën me komponentët e saj më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën autorizohet.

IV

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e QPS-së.

Nënshkrimi i të autorizuarës _____

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Zyrës së Personelit

Të autorizuarës

Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0030952/21
Podujevë, 07 prill 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË TEKNIKE - SHMLT "FAN S. NOLI" NË PODUJEVË

Neni 1

z.Fatmir Emini, nga fshati Peran, Komuna e Podujevës, me nr.pesonal të letërnjoftimit 1014388628, *Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Teknike - SHMLT "Fan S. Noli" në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit*

**Nr. 02-020/02-0031040/21
Podujevë, 07 prill 2021**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “NAIM FRASHËRI“ NË PODUJEVË

Neni 1

z.Besnik Uka, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit 1002189867, *MSC i Shkencave Filologjike*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Naim Frashëri” në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit*

Nr. 02-020/02-0031066/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “SHABAN SHALA“ NË PODUJEVË

Neni 1

z.Rafet Berisha, nga fshati Konushec, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit 1171357663, *Bachelor i Gjeografisë – Edukatë Qytetare*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Shaban Shala” në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit*

Nr. 02-020/02-0031063/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitet në Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “DR. IBRAHIM RUGOVA“ NË PODUJEVË

Neni 1

z.Sheqir Krasniqi, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit 1019927071, *MSC i Shkencave të Gjeografisë*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “DR. Ibrahim Rugova” në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit*

Nr. 02-020/02-0031060/21
Podujevë, 07 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E ZËVENDËS DREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË TEKNIKE - SHMLT "FAN S. NOLI" NË PODUJEVË

Neni 1

znj.Selvie Hoxha, nga fshati Shupkofc, Komuna e Mitrovicës, me vendbanim në Prishtinë, me nr.personal të letërnjoftimit 1015372202, *Inxhinier i Diplomuar i Gjeologjisë*, emërohet;

Zëvendës drejtoreshë e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike - SHMLT "Fan S. Noli" në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e zëvendës drejtoreshës të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarës
Arkivit

Nr. 02-020/02-0031045/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “ENVER MALOKU“ NË PODUJEVË

Neni 1

z.Agim Hamza, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit 1014123314, *MSC i Shkencave të Gjeografisë*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Enver Maloku” në Podujevë

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0031054/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “ZAHIR PAJAZITI” NË FSHATIN ORLLAN KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Naim Bajrami, nga fshati Orllan, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit 1004925447, *MSC i Edukimit - Udhëheqja me Arsim*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan, Komuna e Podujevës

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0031057/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “ZENEL HAJDINI“ NË FSHATIN LUPÇ I POSHTËM KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

znj.Hatixhe Bajgora, nga fshati Llazarevë, Komuna e Obiliqit, me vendbanim në Prishtinë, me nr.personal të letërnjoftimit 1010150058, *Bachelor i Gjuhës Shqipe*, emërohet;

Drejtoreshë e Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Zenel Hajdini” në fshatin Lupç i Poshtëm, Komuna e Podujevës

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtoreshës të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarës
Arkivit

Nr. 02-020/02-0031051/21
Podujevë, 07 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS SË MESME TË ULËT - SHFMU “LUIGJ GURAKUQI” NË FSHATIN BATLLAVË KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Enver Mehana, nga fshati Batllavë, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit 1014680795, *MSC i Mësimdhënies Lëndore (me specializim në Histori)*, emërohet;

Drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët - SHFMU “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë, Komuna e Podujevës

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
Arkivit*

Nr. 02-020/02-0031047/21
Podujevë, 07 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Mbështetur në nenet 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, jep :

A U T O R I Z I M

I

Autorizohet znj.Majlinda Statovci, inspektore e ndërtimit në Drejtorinë e Inspeksionit, të kryej edhe punët dhe detyrat si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit/ës të sektorit për inspektime.

II

Autorizimi vlen deri në një akt tjetër administrativ.

III

E përmendura sipas këtij autorizimi përfiton pagën me komponentët e saj më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën autorizohet.

IV

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushëveprimtaria e pozitës së Udhëheqësit/ës të Sektorit për inspektime në kuadër të Drejtorisë përkatëse.

Nënshkrimi i të autorizuarës 

U dërgohet:
Drejtorisë së Inspeksioni
Zyrës së Personelit
Të autorizuarës
Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0031104/21
Podujevë, 07 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Blliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit të përzgjedhjes së OJQ-ve/ Klubeve sportive për financim publik të aktiviteteve sportive, datë 06.04.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-ve-Klubeve sportive për realizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike dt. 05.02.2021, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **19,000.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0032668/21
Podujevë, dt. 15 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes Thirrjes publike të dt. 08.04.2021, nxjerr:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve për projekt propozimet e shfaqjeve teatrore, për *Skenën e Mbrëmjes*, dhe për *Shfaqje për Fëmijë*, për repertorin e Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”, sipas Thirrjes publike publikuar më 01.03.2021, themelohet komisioni në përbërje:

1. Teuta Ismajli, kryesuese, zyrtare për manifestime - Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
2. Agim Idrizi, anëtar, zyrtar për rini - Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
3. Haxhere Ajvazi, anëtare, shefe e thesarit - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
4. Elisa Durmishi, anëtare- shoqëria civile
5. Ardita Hasani, anëtare- shoqëria civile

Tahir Mehana, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Arkivit

Nr. 02-020/04-0032930/21
Podujevë, 16 prill 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 56 shkronja f) dhe 59.3 të Statutit të Komunës, nr. 01-1/ 298-10, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË INSPEKSIONIT**

Neni 1

z. Bedri Maqastena, bachelor i shkencave kompjuterike, nga Komuna e Podujevës, emërohet:

➤ **Ushtrues i detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës do t'i ushtrorë përkohësisht deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0033328-/21
Podujevë, 19 prill 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 17 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dhe nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritët grupi punues për vlerësimin e draft dokumentit të Hartës Zonale-HZ të Komunës së Podujevës 2020-2028, në përbërje:

1. Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2. Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
3. Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
4. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit
5. Bahrije Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Neni 2

Grupi punues do të bëjë vlerësimin e draft dokumentit të Hartës Zonale sa i përket planifikimeve në fusha përkatëse në funksion të zhvillimit ekonomik dhe interesit strategjik të Komunës duke përfshirë planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e mjedisit, ndërtimin, banimin publik dhe fushave të tjera në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimit të Komunës.


Neni 3

Grupi punues pas vlerësimit të draftit të HZ, varësisht interesit strategjik të Komunës, brenda një afati optimal harton raport sipas të cilit theksohen propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet rreth dokumentit në fjalë dhe në kuadër të autorizimeve ligjore si dhe në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë përkatëse rekomandon për plotësim ndryshimet e nevojshme në draft dokumentin e HZ.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-016/01-0035352/21
Podujevë, 28 prill 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023 nr.01-400/03-0059131/20, dt. 30.09.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002354/21, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-334/07-25043/21, dt. 22.03.2021, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E SERRAVE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Në kuadër të projektit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, "Furnizimi i fermerëve me serra 50 m²", ndahen 250 (dyqind e pesëdhjetë) serra për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës.

Neni 2

Ndarja e serrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0036104/21
Podujevë, 30 prill 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi